



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. Prot.

Tiranë më 28.06.2024

V E N D I M
Nr. 33 datë 28.06.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Henri Naqellari	Kryesues
Loreta Hanxhari	Relatore
Bora Vrenjo	Anëtare

asistuar nga sekretarja e Sekretariatit Teknik, Znj. Lediana Azemaj, në datën 14.06.2024, ora 10:30, në Sallën e Mbledhjeve, kati I, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I VLERËSIMIT:

Z. Sokol Pelivan Cana, me funksion aktual Zëvendës drejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës.

OBJEKTI:

Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoi dhe vlerësoi shpjegimet dhe argumentimin ligjor të Relatorit të çështjes, Znj. Loreta Hanxhari, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në Ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar (në vijim Ligji 12/2018, i ndryshuar).

2. Bazuar në Nenin 6, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, shtetasi *Sokol Cana* është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit që mban si *Zëvendësdrejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës.*

3. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore më datë 05.04.2022, ka shortuar Trupën Vlerësuese dhe më datë 04.07.2023, ka shortuar relatorin e çështjes për subjektin e vlerësimit *Z. Sokol Cana* për t’ju nënshtruar procesit të vlerësimit kalimtar, bazuar në dispozitat e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.07, datë 17.01.2023 “*Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të Ligjit 12/2018, i ndryshuar*”, të përbërë nga Relatore Znj. Loreta Hanxhari, Kryesues *Z. Henri Naqellari* dhe Anëtare Znj. Bora Vrenjo.

4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, më datën 02.08.2023 u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit sipas nenit 27, pika 1, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar dhe neneve 30 dhe 31, të Kodit të Procedurave Administrative.

5. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar, si edhe në bazë të Rregullores nr.197, datë 28.02.2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, me Vendimin nr.1, datë 02.08.2023, vendosi:

- *Të fillojë hetimi kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Sokol Cana me funksion Zëvendësdrejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës.*
- *Të njoftojë me shkrim subjektin e vlerësimit për fillimin e hetimit.*
- *Të bëhet njohja e subjektit të vlerësimit me përbërjen e trupës së vlerësimit për të drejtën e deklarimit të konfliktit të interesit të subjektit me trupën.*

6. Bazuar në nenin 49, të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit *Sokol Cana* në datën 02.08.2023, është njoftuar në adresën elektronike zyrtare të tij, për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, është njohur me përbërjen e Trupës së Vlerësimit, dhe i është kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me ndonjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit sa më sipër.

7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, “Deklaratën për Konfliktin e Interesit” me nr. ** prot. datë 15.08.2023, duke u shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.

8. Relatori i çështjes në përmbushje të detyrave ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, dhe sipas:

- nenit 7, pika 1, të Rregullores nr.197, datë 23.02.2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, nenit 4, të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, ka dërguar me shkresën nr. ** prot., datë 04.08.2023, pranë ILDKPKI-së, formularin e deklarimit të pasurisë për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit .
- nenit 7, pika 7, të Rregullores nr.197, datë 23.02.2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, ka dërguar me shkresën nr. ** prot., datë 04.08.2023, pranë DPPSH-së, formularin e aftësive profesionale për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.
- nenit 7, pika 4 të Rregullores nr.197 datë 23.02.2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, ka dërguar me shkresën nr. ** prot., datë 04.08.2023, pranë AMP-së, deklaratën e kontrollit të figurës për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.

9. Bazuar në nenin 34, pika 3, nenin 42, pika 1 dhe nenin 46, pika 2, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, janë administruar raportet e hartuara nga institucionet ndihmëse: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Agjencia e Mbikëqyrjes Policore (në vijim AMP) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (në vijim DPPSH). Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.

10. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3, të Nenit 25, të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.

11. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.

12. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në Nenin 4, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, ka për objekt:

- a) vlerësimin e pasurisë;
- b) kontrollin e figurës;
- c) vlerësimin e aftësive profesionale.

13. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:

- a) Ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
- b) Ligjin nr. 128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”.
- c) Ligjin nr. 40/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”.
- d) Ligjin nr. 49/2012 “Për Gjykatën Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”.
- e) Ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”.
- f) Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.07, datë 17.01.2023 “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të ligjit 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”.
- g) Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.06, datë 17.01.2023, “Për miratimin e formularëve të deklarimit të Kontrollit të Figurës dhe Vlerësimit të Aftësive Profesionale për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik, si dhe mënyrën e plotësimit të tyre në zbatim të Ligjit nr.12/2018, të ndryshuar”.
- h) Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe ILDKPKI nr.15, datë 27.01.2023, “Për miratimin e formularëve të deklarimit të Pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.
- i) Rregulloren nr.197, datë 23.02.2023 “Për hapat proceduralë të unifikuar”.

Gjithashtu, trupa e vlerësimit ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht:

- *Deklarata e Pasurisë,*
- *Deklarata për Kontrollin e Figurës,*
- *Formulari i Vlerësimit Profesional*
- *Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet,*
- *Tri raportet ndihmëse të hartuara nga institucionet shtetërore;*
- *Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar.*

- *provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.*
- *ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.*

14. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 12 dhe 14, të ligjit 12/2018 të ndryshuar, nenit 3, pika 11 dhe nenit 5, të Ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

15. Trupa e vlerësimit, pasi dëgjoi relatimin e bërë nga relatorja e çështjes dhe studioi materialin e përgatitur për këtë qëllim, krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kanë nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatuan se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Sokol Cana, me Vendimin nr.2, datë 30.05.2024, vendosi:

- Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Sokol Cana;
- Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 - *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht dhe*
 - *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*
- Të ftojë subjektin për t’u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Trupa e Vlerësimit, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

16. Me subjektin e vlerësimit, është komunikuar me anë të postës elektronike duke i bërë pyetje dhe kërkuar sqarime, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave.

17. Subjekti i vlerësimit, pas dërgimit të relacionit paraprak dhe njoftimit me e-mail datë 30.05.2024, mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Trupa Vlerësuese, nuk e ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe atë të njohjes me dosjen.

II. SEANCA DËGJIMORE

18. Subjekti i vlerësimit Sokol Cana u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me e-mail, në datën 12.06.2024, ku dhe u njoftua se seanca publike dëgjimore është përcaktuar për t’u mbajtur në datën 14.06.2024, ora 10:30, në adresën: Salla e Mbledhjeve Kati I, në ambientet e Ministrisë së Brendshme.

19. Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, në datën dhe adresën e përcaktuar.

20. Subjekti i vlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e tij në lidhje me procesin e vlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i vlerësimit Sokol Cana kërkoi nga Trupa Vlerësuese konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

21. Z. Sokol Cana ka qenë bashkëpunues në procesin e vlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar me përpikmëri afatet e përcaktuara nga Trupa Vlerësuese, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. ARSYETIMI LIGJOR I TRUPËS SË VLERËSIMIT

A. VLERËSIMI I PASURISË

22. Në bazë të nenit 32, pika 1, të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, punonjësi deklaron çdo pasuri, të luajtshme apo të paluajtshme, të fituar, poseduar, përdorur apo tjetërsuar që nga data e fillimit të marrëdhënies së punës në institucionin përkatës, pavarësisht datës së emërimit në pozicionin dhe/ose gradën që mban, deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë.

23. Trupa e vlerësimit ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe fakt, për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për punonjësin dhe për personat e lidhur me të, të parashikuar në nenin 31, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

24. Deklarimi i pasurisë nga subjekti kryhet sipas parashikimeve të nenit 32 e 33, ndërsa procedura e vlerësimit të pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

25. Sipas kreut III, neni 33/1, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ILDKPKI-ja bazuar në deklaratimet e pasurisë, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli dhe në përfundim përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

26. Hetimi administrativ i Trupës Vlerësuese pasi administroi dhe u njoh me Raportin e ILDKPKI-së, konsistoi në:

- *verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;*
- *në verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruar si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të deklaruar;*
- *në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;*
- *në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.*

27. Trupa e Vlerësimit për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë, ka thelluar hetimin nëpërmjet:

- a) shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së pasurisë së vlerësimit kalimtar;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhat përkatëse, në raport me të dhënat në deklaratën e vlerësimit kalimtar;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve – gjendje cash;
- ç) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruar nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar.

28. Trupa e Vlerësimit i ka vlerësuar këto deklarime së bashku me provat e tjera në tërësi dhe harmoni me të gjitha rrethanat e çështjes.

29. Subjekti i vlerësimit Z. Sokol Cana ka plotësuar dhe dorëzuar deklaratën e pasurisë dhe dokumentacion justifikues për të justifikuar vërtetësinë e deklarimeve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, në zbatim të nenit 32, pika 2, të ligjit nr.12/2018, i ndyshuar.

30. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33/1, pika 3, e ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, në përfundim të raportit të saj, ka konstatuar se:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklaram të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

DEKLARIMI I PASURIVE NGA SUBJEKTI I VLERËSIMIT

1. Truall me sip. 300 m², nr. pasurie **, ZK 3719, vol. x, faqe xx, Tepelenë. Pjesa takuese 12.5%. Sip. takuese 37.50 m². Vlera e pasurisë 37.500 lekë, vlera takuese

- 4.687 lekë. Kjo sipërfaqe i përket truallit të shtëpisë së vjetër të prindërve në Vasjar, Tepelenë. Burimi i krijimit: Trashëgimi.
2. Ndërtesë me sip. 99 m², nr. pasurie **, ZK 3719, vol. x, faqe xx, Tepelenë. Vlera 965.250 lekë. Pjesa takuese 12.5%. Sip. takuese 12.37 m², vlera takuese 120.656 lekë. Adresa: Njësia Administrative Memaliaj Fshat, Vasjar, Memaliaj, Tepelenë. Burimi i krijimit: shtëpi e vjetër e prindërve në fshatin Vasjar, Tepelenë.
 3. Arë me sip totale 1.600 m², nr. pasurie **, ZK 3719, vol. x, faqe xx, Tepelenë. Vlera 179.200 lekë. Pjesa takuese 12.5%. Sip. takuese 200 m², vlera takuese 22.400 lekë. Adresa: Njësia Administrative Memaliaj Fshat, Vasjar, Memaliaj, Tepelenë. Burimi: ligji 7501, datë 19.07.1991 dhe VKM nr. 432, datë 14.08.1995.
 4. Arë me sip. totale 5.000 m², nr. pasurie **, ZK 3719, vol. x, faqe xx, Tepelenë. Vlera: 560.000 lekë. Pjesa takuese 12.5%. Sip. takuese 625 m², vlera takuese 70.000 lekë. Adresa: Njësia Administrative Memaliaj Fshat, Vasjar, Memaliaj, Tepelenë. Burimi i krijimit: ligji 7501, datë 19.07.1991 dhe VKM nr.432, datë 14.08.1995.
 5. Arë me sip. totale 6.000 m², nr. pasurie **, ZK 3719, vol. x, faqe xx, Tepelenë. Vlera: 672.000 lekë. Pjesa takuese 12.5%. Sip. takuese 750 m², vlera takuese 84.000 lekë.

Burimi i krijimit: ligji 7501, datë 19.07.1991 dhe VKM nr. 432, datë 14.08.1995.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim nga (e-albania) ASHK, DV Tepelenë, datë 13.09.2023, sipas të cilit Sokol Pelivan Cana ka përfitur tokë bujqësore dhe truall (shtëpi banimi), nga ligji 7501 dhe nga VKM nr. 432, datë 14.08.1995, të regjistruara në pronësi të familjes bujqësore Pelivan Cana, si më poshtë:
 - Arë me sip. 6.000 m², me nr pasurie **, ZK 3719, vol. x, faqe xx, Vasjar, Tepelenë. Vlera: 672.000 lekë. Pjesa takuese 1/8. Regjistruar në datën 15.3.2001.
 - Arë me sip. totale 5.000 m², nr. pasurie **, ZK 3719, vol. x, faqe xx, Vasjar, Tepelenë. Pjesa takuese 1/8. Regjistruar në datën 15.03.2001.
 - Arë me sip totale 1.600 m², nr. pasurie **, ZK 3719, vol. x, faqe xx, Vasjar, Tepelenë. Pjesa takuese 1/8. Regjistruar në datën 15.03.2001.
 - Truall me sip. 300 m² + ndërtesë me sip. 99 m², nr. pasurie **, ZK 3719, vol. x, faqe xx, Vasjar, Tepelenë. Pjesa takuese 1/8. Regjistruar në datën 15.03.2001.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

1. ASHK sistemi online, nuk konfirmon pasuri të regjistruar në pronësi të Sokol Cana.
2. ASHK Drejtoria Tepelenë, me shkresë nr. ** prot., datë 16.10.2023, nuk konfirmon pasuri në emër të Sokol Cana dhe të personave të lidhur.
3. Në procesverbalin e datës 13 nëntor 2023, në lidhje me vlerat e shënuara për sipërfaqet e tokës dhe të shtëpisë së vjetër të prindërve në Vasjar, Tepelenë, subjekti sqaroi se në deklaratë ka vendosur vlerat e përcaktuara nga ASHK, për çmimin e m² në zonën përkatëse. Në të vërtetë, ai nuk ka shpenzuar asgjë për asnjërën prej tyre, pasi siç e ka

deklaruar dhe vërtetuar nga dokumentet shoqëruese, sipërfaqet e tokave janë përfituar nga ligji 7501, ndërsa shtëpia ekzistuese e prindërve nuk është rikonstruktuar apo shtuar nga ana e tyre. Pra, as për shtëpinë nuk ka patur shpenzime investuese. Në lidhje me shtëpinë e prindërve në Vasjar, shtoi se ajo ka qenë gjithmonë shtëpia e familjes së tyre. Edhe gjyshërit e tij kanë jetuar aty. Regjistrimi është bërë nga zyra e hipotekës, pas fotografimit që iu bë zonës, nga ajri. Në këtë shtëpi, sot nuk banon asnjë nga familja e tyre. Po kështu edhe nga sipërfaqet e tokës nuk kanë marrë të ardhura, pasi ato nuk shfrytëzohen dhe as nuk janë dhënë me qira.

4. Në datën 21 nëntor 2023, subjekti ka paraqitur pranë ILDKPKI:

- Certifikatë të gjendjes familjare të v. 1991, nga Zyra e Gjendjes Civile, Bashkia Memaliaj, lëshuar në datën 16.11.2023. Përbërja e familjes është me 8 persona, përfshirë prindërit, vëllezërit motrat dhe bashkëshorten.
- Akt të marrjes së tokës në pronësi nr. regj. 7531, rrethi Tepelenë, fshati Vasjar, për familjen e Pelivan Canaj, të cilës i jepet në pronësi tokë gjithsej, me sip. 12.600 m².

5. Bazuar në deklarimin e subjektit dhe dokumentacionin e paraqitur, në mënyrë të përmbledhur rezulton se: Pasuritë e paluajtshme të deklaruara janë përfituar nga ligji 7501 "Për tokën", konkretisht sipas AMTP nr. 7531, për familjen e Pelivan Cana, ku subjekti ka 12.5% pjesë. Vërtetimi nga e-Albania konfirmon pasuritë e deklaruara.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar lidhur me pasuritë e përfituara nga familja bujqësore në fshatin Vasjar, Tepelenë.**
- ✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me vlerat e vendosura pasurive të deklaruara.**

6. **Apartament me sip. 53.60 m², nr. pasurie **, ZK 8533, vol. x, faqe xx, Fier. Vlera 120.894 lekë. Pjesa takuese 50%. Blerë nga EKB Fier, me kontrate shitje apartamenti banimi me sip. 39.43 m²+ truallin 13.71 m², nr.rep. **, nr. kol **, datë 24.06.2002. Burimi i krijimit: kursime familjare. Adresa: rruga "Thoma Kopaçe", njësia nr.x, ndërtesë nr. x, shkalla x, hyrja nr.x, Fier.**

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitje apartamenti nr. ** rep., nr. ** kol., datë 24.06.2002, me palë shitëse Drejtoria Rajonale e EKB Fier dhe palë blerëse Sokol, Pelivan, Minushe, Meto, Majlinda dhe Valbona Cana, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe shfrytëzimi 39.43 m² dhe sipërfaqe e përbashkët 13.71 m². Vlera e apartamentit është 528.931 lekë.
- Kontratë shitblerje nr. ** rep., nr. ** kol., datë 03.10.2002, me palë shitëse Pelivan, Minushe, Majlinda, Meto, Valbona Cana dhe palë blerëse Sokol Cana, për shitjen e pjesës që i përket në bashkëpronësi shitësve në apartamentin me sip. 53.6 m², i regjistruar me nr. pasurie **, në ZK 8533, vol. x, faqe xx, Fier, Sokol Canës me vlerë

100.000 lekë. Vlera është paguar plotësisht jashtë zyrës noteriale, para nënshkrimit të kësaj kontrate.

- Kartelë e pasurisë së paluajtshme, lëshuar në datën 07.10.2002, për apartament me sip. 53.6 m², me nr. pasurie **, në ZK 8533, vol.x, faqe xx, Fier, në pronësi të Sokol Cana, regjistruar në datën 07.10.2002. Vlera 100.000 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

6.1 ASHK Drejtoria Fier, me shkresë nr. ** prot., datë 16.10.2023, konfirmon pasuri nr. **, vol. x, faqe xx, ZK 8533, me sip. 53.6 m², e llojit njësi, regjistruar në datën 07.10.2002, në pronësi të Sokol Cana.

6.2 ASHK sistemi online, nuk konfirmon pasuri në pronësi të subjektit dhe personave të lidhur me të.

6.3 Në procesverbalin e datës 13 nëntor 2023, në lidhje me përcaktimin e apartamentit në pronësi të tij si "njësi" nga ana e ASHK Fier, subjekti sqaroi se ky është një apartament, i cili përdoret prej tyre si shtëpi banimi dhe nuk ka qenë asnjëherë i përdorur si njësi dhe as nuk është transformuar apo dhënë me qira. Për më tepër, apartamenti është i vendosur në katin e dytë të pallatit dhe sikurse shihet nga faturat e UK dhe OSHEE që ka paraqitur, ai përdoret prej tyre kur shkojnë në Fier. Ndërsa në lidhje me personat që kanë firmosur në faqen e fundit të kontratës së shitjes së apartamentit nga EKB, familjes së tij, sqaroi se Agim Cana është vëllai i vogël dhe Mimoza Cana, bashkëshortja.

6.4 Në datën 21 nëntor 2023, subjekti ka paraqitur në Protokollin e ILDKPKI:

- Kopje të kontratës shitje apartamenti nr. ** rep., nr. ** kol., datë 24.06.2002, me palë shitëse Drejtoria Rajonale e EKB Fier dhe palë blerëse Sokol, Pelivan, Minushe, Meto, Majlinda dhe Valbona Cana, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe shfrytëzimi

39.43 m² dhe sipërfaqe e përbashkët 13.71 m². Vlera e apartamentit është 528.931 lekë. Nga kjo vlerë bëhen këto zbritje: Meqenëse blerësi ka statusin "i pastrehë", i zbritet vlera e punimeve të kryera para 01.01.1993. Shuma e përfitimit falas që i takon blerësit në bazë të ligjit 8647, datë 24.07.2000 është 585.000 lekë. Në bazë të VKM nr.

90, datë 25.03.1999, kontrata e shitjes së apartamentit lidhet në vlerën 20.894 lekë; çertifikatë të përbërjes familjare të dt. 31.12.1992, sipas së cilës familja përbëhet nga: Pelivan Cana, Minushe Cana, Sokol Cana, Majlinda Cana, Meto Cana, Valbona Cana, Agim Cana, Mimoza Cana; vendim për dhënie banese punonjësit Sokol Canaj, sipas të cilit me vendim të komisionit të strehimit të Komisarariatit të Policisë Fier, në datën 03.12.1994 i është akorduar apartament banimi 1+1, në Fier, lagjja "8 Shkurti", rruga "Thoma Kopaçe", pallati nr.x, shkalla x, kati x.

6.5 Nëpërmjet e-mail të datës 5 dhjetor 2023, subjekti ka paraqitur:

- Kartelë të pasurisë së paluajtshme për apartament me sip. 53.6. m², me nr. pasurie **, ZK 8533, kodi unik xxxxxxxx, me vlerë 100.000 lekë, regjistruar në datën 07.10.2002, në pronësi të Sokol Cana. Data e lëshimit të kartelës, 02.12.2023.

6.6 Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezulton se: apartamenti në Fier, në pronësi të subjektit, është përfituar në b/pronësi me kontratë shitje të datës 24.06.2002, nga EKB Fier, në vlerën 20.894 lekë dhe më pas me kontratë shitblerje 03.10.2002, nga b/pronarët, me vlerë 100.000 lekë, me burim kursime familjare.

- ✓ **Konfirmohet apartamenti i deklaruar me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e ASHK.**
- ✓ **Subjekti për këtë pasuri plotëson kushtin e përcaktuar në nenin 32, pika 1.1, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, gjithashtu dhe vlera është e papërfillshme, por për transparencë dhe meqenëse kjo është e vetmja pasuri e paluajtshme që subjekti zotëron, konstatohet nga analiza financiare e kryer, se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë.**

7. Automjet Mercedes Benz, marka Daimler Chrysler, targë ABxxxAN, nr. shasie xxxxxx. Blerë nëpërmjet kontratë shitblerje nr. regj. **, datë 09.07.2020, me palë shitëse J. C., pranë DPSHTRR, Fier. Vlera 100.000 lekë. Burimi: kursime nga paga dhe shpërblime. Pjesa takuese 100%.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

7.1 DPSHTRR me shkresë nr. ** prot., datë 11.09.2023, konfirmon se Sokol Cana ka të regjistruar mjetin me targë ABxxxAN. Bashkëlidhur: Kontratë për shitblerjen e automjetit nr. ** regj., datë 09.07.2020, lidhur pranë DPSHTRR, me palë shitëse J.C. dhe palë blerëse Sokol Cana, për blerjen e automjetit Daimler Chrysler me nr. shasie XXXXXXXX, në vlerën 100.000 lekë, e likuiduar jashtë zyrës noteriale.

7.2 Në datën 21 nëntor 2023, subjekti paraqiti në Protokollin e ILDKPKI, kopje të lejes së qarkullimit në emër të tij, për automjetin tip Daimler Chrysler me targë ABxxxAN, nr. shasie XXXXXXXX.

- ✓ **Konstatohet se: Automjeti Mercedes Benz është blerë nga subjekti ne v. 2020, me kursime familjare në vlerën 100.000 lekë.**
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e DPSHTRR.**
- ✓ **Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë.**

8. Gjendje cash në shumën 400.000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhura nga shitje e automjetit Mercedes Benz 200E, me targë FRxxxC, regjistruar në DPSHTRR Fier, në dt.11.05.2005. Blerë nëpërmjet kontratë blerje nr. ** rep., nr. ** kol. Shitur me kontratë shitje nr. ** rep., nr. ** kol., datë 27.03.2010, Fier. Pjesa takuese 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje mjeti nr. ** rep., nr. ** kol., datë 28.02.2005, me palë shitëse H. D. dhe palë blerëse Sokol Cana, për blerjen e automjetit tip Mercedes Benz me nr. shasie XXXXXXXX (targë e huaj) me vlerë 240.000 lekë.
- Kontratë shitje automjeti nr. ** rep., nr. ** kol., datë 27.03.2010, me palë shitëse Sokol Cana dhe palë blerëse L. K., për shitjen e automjetit tip Mercedes Benz me nr. shasie XXXXXXXX, targë FRxxxC, me vlerë 700.000 lekë. Pagesë e kryer jashtë zyrës noteriale.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

8.1 Në procesverbalin e datës 13 nëntor 2023, në lidhje me vlerën e shitjes së automjetit subjekti sqaroi se kur është blerë prej tij, automjeti kishte një defekt elektrik, të cilin pas blerjes e riparoi, gjë që e rriti vlerën e automjetit.

8.2 Në procesverbalin e datës 8 janar 2024, në lidhje me pagesën e kryer për riparimin e automjetit, subjekti sqaroi se megjithëse ka kaluar një kohë e gjatë nga momenti i blerjes së tij, mund të thotë se mban mend që nuk ka qenë pagesë me vlerë shumë të madhe. Afërsisht mund të ketë qenë një shumë prej 25.000 lekësh.

8.3 Në kthim përgjigjet e pyetësorit drejtuar nga Relatorja, subjekti në datë 11.04.2024 ka sqaruar se për mjetin, i cili në kontratën e blerjes në vitin 2005 figuron me targa të huaja, shpenzimet doganore janë kryer nga shitësi sipas fletë zhdoganimit datë 11.07.2003 të dorëzuar bashkëlidhur dhe se subjekti ka kryer vetëm shpenzimet e regjistrimit dhe nxjerrjes së targave.

8.4 Meqenëse mjeti është blerë 240.000 lekë dhe shitur 700.000 lekë sipas kontratave respektive, subjekti është pyetur nëse ka paguar tatim në burim për shumën (700.000-240.000=460.000 lekë) të përfituar nga ky transaksion. Subjekti ka dhënë shpjegime se nuk ka paguar tatim pasi ky lloj tatimi paguhej nga subjektet tregtare apo personat juridik dhe jo nga qytetarët në dijeninë e tij dhe se të gjitha detyrimet pranë Noterisë dhe tek DRSHTRR janë shlyer. Nga ana e trupës vlerësuese nuk u mor parasysh ky argument pasi në zbatim të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshur, neni 8, gërma “g”, e tij, duhet të paguhet tatimi në burim për këtë të ardhur të realizuar. Për këtë arsye shuma prej 460.000 lekë e përfituar nga shitja e automjetit nuk do të merret në konsideratë si e ardhur në analizën financiare të subjektit dhe personave të lidhur me të.

8.5 Gjithashtu në kthim përgjigjet e pyetësorit, subjekti ka sqaruar se megjithëse ka deklaruar në datë 10.03.2023, si burim i gjendjes cash shumë e përfituar nga shitja e mjetit në vitin 2010, ky është një lapsus nga ana e tij pasi shpjegimi më i saktë do ishte që gjendja cash e deklaruar është krijuar nga kursimet e të ardhurave ndër vite duke përfshirë edhe këtë shumë.

- ✓ **Konstatohet se: Automjeti Mercedes Benz 200E është blerë nga subjekti në vitin 2005, me kursime familjare dhe është shitur në vitin 2010.**
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentet e paraqitura. Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me vlerën e shitjes së automjetit në vitin 2010 dhe me burimin e krijimit të gjendjes Cash.**

9. Llogari page nr. 0100xxxxxx, në RFZ Bank me gjendje në datën 01.03.2023 në shumë 450.344 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga për periudhën 01.01.2017 - 01.03.2023. Pjesa takuese 100%.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

9.1 RFZ Bank me shkresë nr: ** prot., datë 04.09.2023, konfirmon llogari page në emër të Sokol Cana me gjendje në datën 10.03.2023, në shumë 582.836 lekë.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi nga RFZ Bank. Diferenca në gjendjet e llogarisë është krijuar nga ndryshimi në datat e pasqyrave bankare me atë të deklarimit.**
- ✓ **Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë.**

10. Fond investimi në RFZ Invest me gjendje, në datë 27.02.2023, në shumë 686.632 lekë.

Data e fillimit 15.08.2016, numri i kuotave të blera 438, vlera e investuar 600.000 lekë.

Burimi i krijimit: kursime në vite nga paga dhe shpërblime në Policinë e Shtetit, për periudhën 1986 - 2016. Pjesa takuese 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim nga RFZ Invest datë 01.03.2023, sipas të cilit Sokol Cana ka investuar në datën 15.08.2016, shumë 600.052 lekë. Vlera aktuale është 686.632 lekë.
- Urdhër për blerjen e kuotave në Fondin e Investimit "RFZ Prestigj", datë 10.08.2016 nga Sokol Cana, për shumë 600.000 lekë, me kohëzgjatje 10.08.2016 deri në 10.08.2017.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

10.1 RFZ Invest, me shkresë nr. ** prot., datë 13.09.2023, konfirmon se Sokol Cana ka investuar në datën 11.08.2016, shumën 600.000 lekë. Gjendja në datën 12.09.2023 është 688.931 lekë.

10.2 Nga verifikimi i llogarisë në RFZ Bank rezulton se shuma 600.000 lekë investuar në blerje kuota në Raiffeisen Invest në datë 15.08.2016, është transferuar nga maturimi i investimit prej 1.000.000 lekësh në Bono Thesari (v.2008-v.2016). Ky investim në Bono Thesari në Maj 2018 (pasuri e tjetërsuar) nuk është deklaruar nga ana e subjektit.

- ✓ **Konstatohet se shuma e investuar në RFZ Invest në vitin 2016, ka si burim kursime familjare, e sqaruar në pikën 10.2.**
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentet e paraqitura dhe përgjigjen e RFZ Invest.**
- ✓ **Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE NGA SUBJEKTI I VLERËSIMIT

- Të ardhura nga paga si punëtor nëntoke në Minierën e Qymyrgurit Memaliaj, gjatë kryerjes së stazhit, pas mbarimit të shkollës së mesme, për periudhën 28.09.1982 - 09.08.1983, në shumën 6.732 lekë.
- Të ardhura nga paga si Shef Ndërlidhje në Repartin e Kufirit dhe Degën e Rendit Publik Tropojë, për periudhën 01.09.1986 - 15.03.1993, në shumën 72.900 lekë.
- Të ardhura nga shitje shtëpi banimi me sip. 63 m², nr. pasurie **, ZK 1347, vol. x, faqe xx, Tropojë, në adresën: Lagjja "Partizani", Rruga "Jaho Salih", pallati nr.x, shkalla nr.x, ap. x, Bajram Curri, Tropojë. Burimi: Përfitur nga privatizimi i banesave me vlerë 8.640 lekë. Shitur shtetasit Qazim Logu, me kontratë shitje datë 19.07.1994. Shuma 300.000 lekë.
- Të ardhura nga paga dhe shpërblime nga puna si specialist në Zyrën e Veprimeve Operacionale në SHKB, në Ministrinë e Rendit Publik, për periudhën 01.04.2003 - 30.04.2006, në shumën 1.088.600 lekë.
- Të ardhura nga paga dhe shpërblime nga puna si Shef i Seksionit të Gjurmimit Teknik, në Drejtorinë e Policisë të Qarkut Fier, për periudhën 16.05.2006 - 11.05.2010, në shumën 2.979.868 lekë.
- Të ardhura nga shitja e automjetit Mercedes Benz, me targë FRxxxC, blerë në vitin 2005, me vlerë 240.000 lekë dhe burim kursimet familjare. Shitur me kontratë nr. ** rep., nr. ** kol., date 27.3.2010, në shumën 700.000 lekë.
- Të ardhura nga paga dhe shpërblime nga puna si Shef i Sektorit të Analizës dhe Informacionit Kriminal, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Korçë, për periudhën 12.05.2010 - 07.02.2011, në shumën 726.546 lekë.

- Të ardhura nga paga dhe shpërblime nga puna si Shef i Sektorit të Operacioneve Speciale dhe Kërkimit, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Fier, për periudhën 08.02.2011 - 04.11.2012, në shumën 1.561.852 lekë.
- Të ardhura nga paga dhe shpërblime nga puna si Shef i Njesisë së Forcës së Posaçme Operacionale, Fier-Vlorë-Berat-Gjirokastrë, në Drejtorinë e Posaçme Operacionale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për periudhën 05.11.2012 - 14.11.2013, në shumën 1.013.088 lekë.
- Të ardhura nga paga dhe shpërblime nga puna si specialist Oficer i Policisë Gjqësore Përgjimi, Sektori i Përgjimit të Telekomunikimeve në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për periudhën 15.11.2013 - 06.03.2016, në shumën 3.128.441 lekë.
- Të ardhura nga paga, dieta dhe shpërblime nga puna si specialist i Vlerësimit të Kërcënimit në Drejtorinë e Antiterrorit, për periudhën 07.03.2016 - 21.10.2021; Drejtor i Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Gjirokastrë, për periudhën 21.10.2021 - 23.12.2022; Zv/Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës, për periudhën 23. 12.2022 - 01.03.2023, në shumën 9.639.365 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje datë 15.09.1993, midis NKB si shitës dhe Sokol e Mimoza Canaj blerës, për blerjen e banesës me sip. 63 m², në Rr. "Jaho Salihi", në shumën 8.640 lekë. Apartamenti është regjistruar në hipotekë Tropojë, me nr. regj. 61, në datën 10.02.1994.
- Kontratë shitje nr. ** rep., nr. ** kol., datë 19.07.1994, me shitës Sokol dhe Mimoza Canaj dhe blerës Qazim Logu, për shitjen e apartamentit me sip. 63 m², në Rr. "Jaho Salihi", Tropojë, me vlerë 300.000 lekë.
- Vërtetim datë 01.03.2023, nga RFZ Bank, sipas të cilit llogaria e pagës së Sokol Cana është kredituar, për periudhën 2005 - 2023; ka kryer një investim në bono thesari, në datën 13.05.2008 deri në 07.05.2009, në shumën 1.000.000 lekë. Investimi është përsëritur në vitet 2009, 2010, 2011, 2012, 2013 dhe nuk është riinvestuar më në 12.06.2014.
- Vërtetim nr. ** prot., datë 13.04.2018, nga Komisariati i Policisë Tropojë, sipas të cilit Sokol Cana, për periudhën 01.09.1986 - 28.02.1993, ka qenë punonjës policie pranë Komisarariatit të Policisë, Tropojë. Për pagat e kësaj periudhe institucioni nuk disponon dokumente, pasi ato janë djegur në vitin 1997.
- Nxjerrje llogarie nga BKT, datë 18.04.2018, sipas së cilës, llogaria e pagës së Sokol Cana është kredituar për periudhën 04.03.2011 - 28.01.2014, në shumën 1.507.452 lekë.
- Vërtetim nr. ** prot., datë 12.04.2018, nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, sipas së cilit, Sokol Cana, për periudhën 01.09.1993 - 31.03.2003, ka përfituar të ardhura neto si më poshtë: Për periudhën 01.09.1993 - 31.03.2005, të ardhura nga paga dhe shpërblime në shumën 1.726.502 lekë. Për trajtimin me pagesë për bashkëshorten ka përfituar të ardhura në shumën 68.039 lekë.
- Vërtetim nr. ** prot., datë 29.01.2015, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, sipas të cilit Sokol Cana është punonjës në Departamentin e Krimit të Organizuar dhe Krimet e Rënda, me pagë mujore neto në shumën 104.898 lekë. Bashkëshortja e tij, Mimoza Cana trajtohet financiarisht me pagë mujore neto në shumën 19.586 lekë.

- Nxjerrje llogarie nga RFZ Bank, datë 01.03.2023, sipas së cilës, llogaria e pagës së Sokol Cana është kredituar për periudhën 04. 01.2017 - 01.03.2023.
- Vërtetim nr. ** prot., datë 13.05.2019, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, sipas së cilit, Sokol Cana është punonjës në Drejtorinë e Antiterrorit dhe të ardhurat financiare neto për vitin 2018, janë në shumën 1.057.944 lekë. Të ardhurat nga mbikoha e punës për vitin 2018, janë në shumën 112.007 lekë. Akt verifikimi i vjetërsisë në punë para vitit 1994, datë 06.03.2023, nga DRSSH Gjirokastrë, sipas së cilit, Sokol Canaj, në periudhën shtator 1982 - janar 1983 dhe korrik - gusht 1983, ka përfituar pagë në shumën 2.255 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

1. BKT, me shkresë nr. ** prot., datë 13.09.2023, konfirmon llogari page në emër të Sokol Cana, në të cilën kreditohen të ardhurat nga paga për periudhën 04.03.2011 - 31.12.2012, në shumën 1.507.452 lekë, nga Policia e Shtetit.
2. RFZ Bank, me shkresë nr. ** prot., datë 04.09.2023, konfirmon llogari page në emër të Sokol Cana, në të cilën kreditohen të ardhurat nga paga, për periudhën 05.05.2005 - 09.03.2023, në shumën 17.982.622 lekë, nga Policia e Shtetit.
3. ISSH, me shkresën nr. ** prot., datë 06.09.2023, konfirmon se Sokol Cana ka përfituar të ardhura/neto nga Policia e Shtetit, për periudhën janar 2012 – korrik 2023. Gjithashtu ka qenë i punësuar në Minierën e Qymyrgurit Memaliaj, për periudhën shtator 1982 - gusht 1983.
4. Në procesverbalin e datës 13 nëntor 2023, në lidhje me të ardhurat e deklaruara për periudhën 1986 - 1993, nga punësimi në Tropojë, subjekti sqaroi se shuma prej 72.900 lekë është llogaritur si vlera e përgjithshme e pagave që ka përfituar në atë periudhë, pasi sikurse shihet edhe nga vërtetimi që ka paraqitur, dokumentet e asaj periudhe janë djegur gjatë vitit 1997. Përsa i përket vërtetimit të paraqitur prej tij, për të ardhura të krijuara në periudhën 01.09.1993 - 31.03.2003, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, periudha e saktë është deri në vitin 2003, pasi më vonë ka kaluar në Zyrën e Veprimeve Operacionale në SHKB, në Ministrinë e Rendit Publik, për periudhën 01.04.2003 - 30.04.2006.
5. Për periudhën 01.04.2003-30.04.2005, subjekti me kërkesë të Trupës paraqiti dokumentacion justifikues, Vërtetim nr. ** prot., datë 11.04.2024 nga Ministria e Brendshme ku rezulton se të ardhurat neto të përfituara janë 1.332.038 lekë për subjektin dhe 185.250 lekë nga trajtimi me pagesë për bashkëshorten.
6. Gjithashtu në lidhje me të ardhurat e përfituara nga trajtimi me pagesë i bashkëshortes për periudhën Maj 1998- Maj 2005, për të cilën nuk është e mundur të disponojmë transaksione bankare, i është kërkuar subjektit të na vendosë në dispozicion Vërtetimet përkatëse për bazën e vlerësueshme nga DVP Fier. Subjekti në përgjigjet e pyetësorit me

shkresë nr.61/19 prot, datë 11.04.2024, ka dorëzuar Vërtetimet datë 08.04.2024, nga DVP Fier për përfitimet shtesë në pagë për bashkëshorten për periudhën 01.05.1998-01.04.2003.

7. Të ardhurat e subjektit nga paga dhe shpërblimet për periudhën 01.09.1986 - 10.03.2023, rezultojnë në total në shumën rreth 22.345.181 lekë. Në këtë vlerë nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat e krijuara para vitit 1993, për arsyen e mos sigurimit dhe dorëzimit të dokumentacionit për shkak të djegjes së dokumentave në arkivën Lundër, sipas shkresës nga ISSH, si dhe janë vlera të pa përfillshme.
8. Të ardhurat neto nga shitje apartamenti në Tropojë në vitin 1994, rezultojnë në shumën 300.000 lekë - 8640 lekë = 291.360 lekë.

SHPENZIME TË DEKLARUESHME

Të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur – Periudha nga 01.01.2020 - 31.12.2022.

- Shpenzime për internet dhe telefon për vitin 2022, në shumën 39.600 lekë.
- Shpenzime për qira banese, në vitin 2022, për apartment me sip.49 m2, Rr. "Shyqyri Ishmi", pallati x, shkalla x, ap.x, Tiranë, në shumën 240.000 lekë.
- Shpenzime për energji elektrike në vitin 2022, për banesën në Tiranë në shumën 45.118 lekë dhe për banesën në Fier, në shumën 7.347 lekë. Gjithsej në shumën 52.465 lekë.
- Shpenzime për ujë në vitin 2022, për banesën në Tiranë në shumën 6.006 lekë; për banesën në Fier në shumën 8.786 lekë. Gjithsej në shumën 14.792 lekë. Shpenzimet në total për vitin 2022, janë në shumën 346.857 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë qiraje nr. ** prot., nr. ** kol., datë 31.08.2016, me qiradhënës Drita Kraja dhe qiramarrës Sokol Cana, për dhënie me qira të apartamentit me sip. 49 m2, në Rr. "Shyqyri Ishmi", pallati x, shk.x, ap.x, Njësia Bashkiake nr. 2, e regjistruar në ZVRPP Tiranë, me nr. regjistri 24429, datë 31.08.1994, për periudhën 01.09.2016 - 31.08.2017. Vlera 20.000 lekë në muaj do të paguhet në cash.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

1. Në procesverbalin e datës 13 nëntor 2023, në lidhje me kontratën e qiramarrjes së këtij apartamenti, subjekti sqaroi se kontrata e paraqitur prej tij ka vazhduar edhe në vitet më pas, deri edhe aktualisht me të njëjtat kushte të pandryshuara. Zonja që ia ka dhënë me qira është në moshë të thyer dhe e ka patur të pamundur të shkojë në zyren noteriale, për përsëritjen e kontratës. Përsa i takon shlyerjes së detyrimit tatimor të fitimit të realizuar nga qiradhënia, sqaroi se aktualisht nuk ka dijeni për shlyerjen nga qiradhënesi.
2. Nëpërmjet postës elektronike të datës 23 nëntor 2023, subjekti paraqiti:

- Kontratë qiraje datë 01.09.2017, me qiradhënëse Drita Kraja dhe qiramarrës Sokol Cana, për dhënie me qira të apartamentit me sip. 49 m2, në Rr. "Shyqyri Ishmi", pallati x, shk.x, ap.x, Tiranë, për periudhën 01.09.2017 - 31.08.2018. Vlera 20.000 lekë në muaj do të paguhet në cash;
 - Kontratë qiraje datë 01.09.2018, me qiradhënëse Drita Kraja dhe qiramarrës Sokol Cana, për dhënie me qira të apartamentit me sip. 49 m2, në Rr. "Shyqyri Ishmi", pallati x, shk.x, ap.x, Tiranë, për periudhën 01.09.2018 - 31.08.2019. Vlera 20.000 lekë në muaj do të paguhet në cash;
 - Kontratë qiraje datë 01.09.2019, me qiradhënëse Drita Kraja dhe qiramarrës Sokol Cana, për dhënie me qira të apartamentit me sip. 49 m2, në Rr. "Shyqyri Ishmi", pallati x, shk.x, ap.x, Tiranë, për periudhën 01.09.2019 - 31.08.2020. Vlera 20.000 lekë në muaj do të paguhet në cash;
 - Kontratë qiraje datë 01.09.2020, me qiradhënëse Drita Kraja dhe qiramarrës Sokol Cana, për dhënie me qira të apartamentit me sipërfaqe 49 m2, në Rr. "Shyqyri Ishmi", pallati x, shk.x, ap.x, Tiranë, për periudhën 01.09.2020 - 31.08.2021. Vlera 20.000 lekë në muaj do të paguhet në cash;
 - Kontratë qiraje datë 01.09.2021, me qiradhënëse Drita Kraja dhe qiramarrës Sokol Cana, për dhënie me qira të apartamentit me sipërfaqe 49 m2, në Rr. "Shyqyri Ishmi", pallati x, shk.x, ap.x, Tiranë për periudhën 01.09.2021 - 31.08.2022. Vlera 20.000 lekë në muaj do të paguhet në cash;
 - Kontratë qiraje datë 01.09.2022, me qiradhënëse Drita Kraja dhe qiramarrës Sokol Cana, për dhënie me qira të apartamentit me sipërfaqe 49 m2, në Rr. "Shyqyri Ishmi", pallati x, shk.x, ap.x, Tiranë, për periudhën 01.09.2022 - 31.08.2023. Vlera 20.000 lekë në muaj do të paguhet në cash.
 - Kopje e librezës së UK Tiranë, për kontratën nr. xxxxx-1, në emër të Drita Kraja, ku janë pasqyruar pagesa të kryera në vitin 2022, në shumën 6.708 lekë.
 - Kopje e librezës së OSHEE Tiranë, për kontratën nr. Exxxxxx, në emër të Skënder Kraja, ku janë pasqyruar pagesa të kryera në vitin 2022, në shumën 45.105 lekë.
 - Kopje e librezës se UK Fier, për kontratën nr. 1500xxx, në emër të Sokol Cana, ku janë pasqyruar pagesa të kryera në vitin 2022, në shumën 8. 171 lekë.
 - Kopje e librezës së OSHEE Fier, për kontratën nr. 17788, në emër të Sokol Cana, ku janë pasqyruar pagesa të kryera në vitin 2022, në shumën 11.333 lekë.
 - Kopje e librezës së telefonisë fikse, për nr. e telefonit 034xxxxx, në emër të Mimoza Cana, ku janë pasqyruar pagesa të kryera në vitin 2022, në shumën 21.600 lekë.
3. Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU), me shkresë nr. ** prot., datë 11.09.2023, konfirmon se në emër të Sokol Cana, për periudhën deri në datë 10.03.2023, identifikohet 1 abonent me kontratë të furnizimit nr. xxxxxxx në instancën Fier (adresa Th. Kopace).
 4. Shoqëria Rajonale Ujësjiellës - Kanalizime Fier, me shkresë nr. ** prot., datë 06.09.2023, konfirmon se në emër të Sokol Cana dhe personave të lidhur me të, nuk rezulton të jetë lidhur asnjë kontratë për furnizimin me ujë.

5. Në procesverbalin e datës 13 nëntor 2023, në lidhje me informacionin e ardhur nga Shoqëria Rajonale Ujësjetës - Kanalizime Fier, subjekti sqaroi se ka paraqitur kopje të librezës së lëshuar nga UK Fier, nëpërmjet të cilës, shlyen detyrimet në mënyrë të rregullt. Në këtë librezë është shënuar numri i kontratës së tij, i cili është 1500722.
6. Trembëdhjetë (13) Shoqëritë Rajonale të Ujësjetës - Kanalizime, me shkresat nr. ** prot., nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
7. Subjekti është pyetur duke ju referuar emërimeve sipas karrierës së tij profesionale, gjatë periudhës që ka qenë i emëruar pranë SHKB Tiranë, në DPQ Korçë, Drejtorinë e Forcave Posaçme Operacionale dhe aktualisht në Kukës, se ku ka qëndruar si vendbanim(adresa) dhe nëse ka patur shpenzime qeraje.
8. Në përgjigjet e tij me nr. ** prot., datë 27.05.2024, subjekti ka sqaruar se : “Kur kam qenë i punësuar pranë Drejtorisë Përgjithshme të SHKB Tiranë, zyrat tona kanë qenë në godinën e Ministrisë së Brendshme e cila kishte marrë edhe Godinën e Hotel Arbana, ku sot është Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe akoma kishte gjithë infrastrukturën si Hotel ku kishin dhoma ish Deputetët e asaj kohe të cilët u larguan nga godina dhe aty u sistemuan për të fjetur disa oficerë që vinin nga rrethet midis të cilëve edhe unë. Kur kam punuar në DPQ Korçë, kemi patur krevate në zyra dhe aty kemi qëndruar për punë e fjetje. Kur kam punuar si Shef Njësie Operacionale, në Drejtorinë e Forcës Posaçme Operacionale, unë kam banuar në Fier, në banesën time, pasi unë drejtoja Njësinë e Forcës së Posaçme për zonën e Jugut që mbulonte qarqet Fier, Vlorë, Berat, Gjirokastër dhe qendra e Njësies Operacionale të Jugut ishte në Fier, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë, Godinë më vete. Edhe tani që punoj në DVP Kukës përdorim ambjente të Drejtorisë për të fjetur, pra për gjithë periudhën e mësipërme nuk kam patur shpenzime qeraje, pasi jam sistemuar në ambjentet ku kam punuar.”
9. Vodafone Albania sh.a. me shkresë nr. ** prot., datë 12.01.2024, konfirmon se në emër të Sokol Cana janë regjistruar tre numra celularë: 06921...150, 06938...27, 09641...374. Për secilin prej tyre është paguar shuma 6.000 lekë për vitin 2022. Në total, për vitin 2022 është paguar shuma 18.000 lekë.
10. One Albania sh.a. me shkresën nr. ** prot., datë 06.09.2023, konfirmon se në emër të Sokol Cana dhe të personave të lidhur me të, nuk rezulton të ketë kontrata për shërbimin e telefonisë ose të internetit.
11. Albania Satellite Communications shpk, me shkresën nr. ** prot., datë 12.09.2023, nuk konfirmon kontrata të nënshkruara nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
12. Abissnet sh.a, me shkresën nr. ** prot., datë 18.09.2023, nuk konfirmon kontrata të nënshkruara nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

13. Digicom sh.a, me shkresën nr. ** prot., dt 11.09.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
14. Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e FSHU, UKT, Vodafone. Shpenzimet e deklaruara për qira, ujë + drita + telefoni + internet gjatë periudhës së sipërcituar, me kontrata në emër të subjektit, rezultojnë në total rreth 351.000 lekë.
15. Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara - Periudha 01.01.2020 - 31.12.2022: Në datën 21 nëntor 2023, subjekti ka paraqitur në protokollin e ILDKPKI, dokument të printuar nga sistemi TIMS, datë 19.11.2023, sipas të cilit subjekti ka udhëtuar: për vitin 2022:
 - Datë 10.03.2022 - 10.03.2022, me autoveturë nga Kakavija (udhëtim brenda ditës).
 - Datë 14.07.2022 - 14.07.2022, me autoveturë nga Kakavija (udhëtim brenda ditës).
16. Nëpërmjet postës elektronike të datës 23 nëntor 2023, subjekti ka paraqitur dokument të printuar nga sistemi TIMS, datë 23.11.2023, sipas të cilit bashkëshortja Mimoza Cana dhe vajza Arjola Cana, nuk kanë patur udhëtime jashtë territorit të RSH, për periudhën 2020 - 2022.
17. Nga verifikimi i lëvizjeve në sistemin TIMS para vitit 2020, lëvizjet e subjektit dhe personave të lidhur me të janë të pakta dhe të pa konsiderueshme për tu marrë në analizë.
18. Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar sa i përket hyrje-daljeve nga RSH, gjatë periudhës 2020 – 2022, të subjektit dhe personave të lidhur me të. Subjekti ka paraqitur dokumentacion të nxjerrë nga sistemi TIMS.

DEKLARIMI I BASHKËSHORTES - MIMOZA CANA

DEKLARIMI I PASURIVE

1. Arë me sip totale 1.600 m², nr. pasurie **, ZK 3719, vol.x, faqe xx, Tepelenë. Vlera 179.200 lekë. Pjesa takuese 12.5%. Sip. takuese 200 m², vlera takuese 22.400 lekë. Adresa: Njësia Administrative Memaliaj Fshat, Vasjar, Memaliaj, Tepelenë. Burimi: ligji 7501, datë 19.07.1991 dhe VKM nr.432, datë 14.08.1995.
2. Ndërtesë me sip. 99 m², nr. pasurie **, ZK 3719, vol. x, faqe xx, Tepelenë. Vlera 965.250 lekë. Pjesa takuese 12.5%. Sip. takuese 12.37 m², vlera takuese 120.656 lekë. Adresa: Njësia Administrative Memaliaj Fshat, Vasjar, Memaliaj, Tepelenë. Burimi i krijimit: shtëpi e vjetër e prindërve të bashkëshortit në fshatin Vasjar, Tepelenë.
3. Truall + ndërtesë e regjistruar në datë 15.03.2001, me sip.300 m², nr. pasurie **, Z.K 3719, vol. x, faqe xx, Tepelenë. Pjesa takuese 12.5%. Sip. takuese 37.50 m².

Vlera e pasurisë 37.500 lekë, vlera takuese 4.687 lekë. Kjo sipërfaqe i përket truallit të shtëpisë së vjetër të prindërve të bashkëshortit, në Vasjar, Tepelenë. Adresa: Gjirokastër, Memaliaj Fshat, Fshati Vasjar, Tepelenë. Burimi i krijimit: Trashëgimi.

4. Arë me sip. totale 5.000 m², nr. pasurie **, ZK 3719, vol. x, faqe xx, Tepelenë. Vlera: 560.000 lekë. Pjesa takuese 12.5%. Sip. takuese 625 m², vlera takuese 70.000 lekë. Adresa: Njësia Administrative Memaliaj Fshat, Vasjar, Memaliaj, Tepelenë. Burimi i krijimit: ligji 7501, datë 19.07.1991 dhe VKM nr.432, datë 14.08.1995.
5. Arë me sip. totale 6.000 m², nr. pasurie **, ZK 3719, vol. x, faqe xx, Tepelenë. Vlera: 672.000 lekë. Pjesa takuese 12.5%. Sip. takuese 750 m², vlera takuese 84.000 lekë. Burimi i krijimit: ligji 7501, datë 19.07.1991 dhe VKM nr.432, datë 14.08.1995.
6. Apartment me sip. 53.60 m², regjistruar në datë 24.06.2002, me nr. pasurie **, Z.K 8533, vol. x, faqe xx, Fier. Vlera 120.894 lekë. Pjesa takuese 50%. Blerë nga EKB Fier. Burimi i krijimit: kursime familjare në shumën 20.894 lekë dhe 100.000 lekë pjesa e familjarëve dhe të ardhura nga shitja e banesës së përfituar nga privatizimi në Bajram Curri. Pjesa takuese 50%. Adresa: rruga "Thoma Kopaçe", njësia nr.3, ndërtesë nr. x, shkalla x, hyrja nr.x, Fier.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

Trajtuar më sipër.

7. Llogari në RFZ Bank me gjendje në datën 01.03.2023, në shumën 445.516 lekë. Burimi i krijimit: të ardhura të krijuara nga trajtimi me pagesë sipas VKM nr.507, datë 18.07.2003 dhe VKM nr. 183, datë 09.02.2011, për periudhën maj 2005 - 31.03.2015. Pjesa takuese 100%.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

- 7.1 RFZ Bank, me shkresë nr. ** prot., datë 04.09.2023, konfirmon llogari page në emër të Mimoza Canaj, me gjendje në datën 10.03.2023, në shumën 445.516 lekë.

- ✓ Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e ardhur nga RFZ Bank.
- ✓ Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë.

8. Investim në RFZ Invest me gjendje në datën 27.02.2023, në shumën 1.044.662 lekë. Burimi: të ardhura nga paga për periudhën 1981 - 1990, si edhe trajtimi me pagë si bashkëshorte e papunë e punonjësit të policisë për periudhën 1991 - 2005, maturuar në bono thesari në vitet 2008 - 2013. Kaluar në investim në RFZ Prestigj, në datën 20.05.2013 deri në datën 27.02.2023. Pjesa takuese 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim nga RFZ Invest datë 01.03.2023, sipas të cilit Mimoza Cana ka investuar në datën 19.05.2013, shumën 729.200 lekë. Vlera aktuale është 1.044.662 lekë.
- Kontratë depozite me afat, datë 18.05.2009, midis RFZ Bank dhe Mimoza Cana, për investimin e shumës 180.200 lekë, në depozitë 24 - mujore.
- Kontratë depozite me afat, datë 18.05.2011, midis RFZ Bank dhe Mimoza Cana, për investimin e shumës 573.500 lekë, në depozitë 12- mujore.
- Kontratë depozite me afat, datë 18.05.2012, midis RFZ Bank dhe Mimoza Cana, për investimin e shumës 616.400 lekë, në depozitë 12- mujore.
- Kontratë depozite me afat, datë 20.06.2014, midis RFZ Bank dhe Mimoza Cana, për investimin e shumës 132.400 lekë, në depozitë 6- mujore.
- Kontratë depozite me afat, datë 20.05.2015, midis RFZ Bank dhe Mimoza Cana, për investimin e shumës 445.000 lekë, në depozitë 12-mujore.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

- 8.1 RFZ Invest, me shkresë nr. ** prot., datë 13.09.2023, konfirmon se Mimoza Cana ka investuar në datën 19.05.2013, shumën 729.200 lekë. Gjendja në datën 12.09.2023, është 1.048.160 lekë.
- 8.2 Nga veprimet e kryera pranë RFZ Bank shihet qartë se shuma prej 729.200 lekësh është krijuar nga depozitat bankare të sipërcituara së bashku me interesin neto të përfituar dhe shtesat përkatëse deri në maturimin e depozitës me afat në datë 18.05.2013.
- 8.3 Në lidhje me dy depozitat e fundit të cituara më lart, vihet re se nga llogaria rrjedhëse e të ardhurave nga paga kanë kaluar në depozitë dhe përsëri janë kthyer në llogarinë pranë RFZ Bank, gjendja e të cilës është trajtuar në pikën 7 të pasurisë.

- ✓ **Konstatohet se: shuma e investuar në RFZ Invest në vitin 2013, ka si burim kursime familjare.**
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentet e paraqitura dhe me përgjigjen e RFZ Invest.**
- ✓ **Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë.**

9. Llogari page në Tirana Bank, me gjendje në datën 02.03.2023, në shumën 98.252 lekë.

Burimi: të ardhura nga paga si punëtore në ELKA-SA. Pjesa takuese 100%.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

- 9.1 Tirana Bank me shkresë nr. ** prot., datë 06.09.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të Mimoza Cana, me gjendje në datën 10.03.2023, në shumën 98.252 lekë.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e ardhur nga Tirana Bank.**
- ✓ **Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Të ardhura nga puna në Repartin Mekanik në Ndërmarrjen e Riparim Furnizimit të Instrumenteve të Shpimit, Fier, për periudhën 02.02.1981 - 07.1990, në shumën 59.280 lekë.
 - Të ardhura të përfituara nga trajtimi me pagesë sipas VKM nr. 86, datë 12.03.1992 për periudhën 18.07.1991 - 31.12.1993, në shumën 69.600 lekë.
 - Të ardhura të përfituara nga trajtimi me pagesë sipas VKM nr.86, datë 12.03.1992, për periudhën 01.01.1994 - 30.04.1998, në shumën 68.039 lekë.
 - Të ardhura të përfituara nga trajtimi me pagesë sipas VKM nr.86, datë 12.03.1992, për periudhën 30.04.1998 - 01.04.2003, në shumën 371.032 lekë.
 - Të ardhura të përfituara nga trajtimi me pagesë sipas VKM nr.507, datë 18.07.2003, për periudhën 01.04.2003 - 05.05.2005, në shumën 230.184 lekë.
 - Të ardhura të përfituara nga trajtimi me pagesë sipas VKM nr.507, datë 18.07.2003 dhe VKM nr. 183, datë 09.02.2011, për periudhën 05.05.2005 - 31.03.2015, në shumën 445.336 lekë.
 - Të ardhura të përfituara nga puna dhe trajtimi me pagesë si bashkëshorte e papunë e punonjësit të policisë, sipas VKM, për periudhën 02.02.1981 - 31.07.1990 dhe 18.07.1991 - 31.03.2015, në shumën totale 1.237.471 lekë.
 - Të ardhura nga paga si punëtore në ELKA-SA, për periudhën shtator - dhjetor 2022, në shumën 98.502 lekë.
- Bashkëlidhur deklaratës:
- Vërtetim nr. ** prot., datë 13.04.2018, nga Komisariati i Policisë Tropojë, ku rezulton se Mimoza Cana është bashkëshortja e Sokol Cana, i cili për periudhën 01.09.1986 - 28.02.1993 ka qenë punonjës policie pranë Komisarariatit të Policisë, Tropojë. Për Mimoza Cana, e papunë gjatë kësaj periudhe, nuk ka të dhëna, pasi dokumentat e pagave janë djegur në vitin 1997.
 - Nxjerrje llogarie nga BKT, datë 18.04.2018, sipas të cilës llogaria e pagës së Mimoza Cana për periudhën 04.04.2011 - 23.01.2014, është kredituar në shumën 360.379 lekë.
 - Vërtetim nr. ** prot., datë 12.04.2018, nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, sipas së cilit Sokol Cana për periudhën 01.09.1993 - 31.03.2003, ka përfituar të ardhura neto si më poshtë:
Për periudhën 01.09.1993 - 31.03.2005, të ardhura nga paga dhe shpërblime në shumën 1.726.502 lekë;
Për trajtimin me pagesë për bashkëshorten ka përfituar të ardhura në shumën 68.039 lekë, për periudhën 01.01.1994 - 30.04.1998.
 - Nxjerrje llogarie nga RFZ Bank, datë 18.04.2018, sipas së cilës llogaria e pagës së Mimoza Canaj është kredituar për periudhën 05.05.2005 - 30.03.2018.

- Vërtetim nr. ** prot., datë 29.01.2015, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, sipas të cilit Sokol Cana është punonjës në Departamentin e Krimit të Organizuar dhe Krimet e Rënda, me pagë mujore neto në shumën 104.898 lekë. Bashkëshortja e tij, Mimoza Cana trajtohet financiarisht me pagë mujore neto në shumën 19.586 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

1. RFZ, me shkresë nr. ** prot., datë 04.09.2023, konfirmon llogari page në emër të Mimoza Cana, në të cilën kreditohen të ardhurat nga paga, për periudhën 05.05.2005 - 01.04.2015, në shumën 1.234.532 lekë, nga Policia e Shtetit.
2. BKT, me shkresë nr. ** prot., datë 13.09.2023, konfirmon llogari page në emër të Mimoza Cana, në të cilën kreditohen të ardhurat nga paga, për periudhën 04.04.2011 - 31.12.2012, në shumën 360.412 lekë, nga Policia e Shtetit.
3. Tirana Bank, me shkresë nr. ** prot., datë 06.09.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të Mimoza Cana, në të cilën kreditohen të ardhurat nga paga për periudhën 05.10.2022 - 01.03.2023, në shumën 99.000 lekë.
4. ISSH, me shkresë nr. ** prot., datë 06.09.2023, konfirmon se Mimoza Cana ka përfituar të ardhura neto nga Policia e Shtetit, për periudhën janar 2012 - prill 2015 dhe nga ELKA-SA, për periudhën shtator 2022 - dhjetor 2022. Gjithashtu, ka qenë e punësuar në Ndërmarrjen e Riparim Furnizim Instrumenteve të Shpimit Fier, për periudhën shkurt 1981 - nëntor 1985.
5. Të ardhurat e krijuara para vitit 1993, për arsyen e mos sigurimit dhe dorëzimit të dokumentacionit për shkak të djegjes së dokumentave në arkivën Lundër, sipas shkresës nga ISSH, nuk janë marrë në konsideratë.
6. Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga trajtimi me pagesë dhe paga, për periudhën 01.01.1994 - 10.03.2023, rezultojnë në total në shumën rreth 1.916.215 lekë.

DEKLARIMI I VAJZËS - ARJOLA CANA

DEKLARIMI I PASURIVE

1. Llogari në RFZ Bank me gjendje në datën 31.12.2022, në shumën 11.892 lekë.
Burimi:
të ardhura nga paga e babait, kaluar në datën 06.09.2019, shuma fillestare 50.000 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

1.1 RFZ Bank, me shkresë nr. ** prot., datë 04.09.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të Arjola Cana, me gjendje në datën 10.03.2023, në shumën 10.559 lekë.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e RFZ Bank.**
- ✓ **Diferenca në gjendjet e llogarisë është krijuar nga ndryshimi në datat e pasqyrave bankare me atë të deklarimit.**
- ✓ **Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë.**

2. Llogari në Credins Bank, me gjendje në datën 02.03.2023, në shumën 125.947 lekë.
Burimi: Të ardhura nga pagesa si studente ekselente.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

2.1 Credins Bank, me shkresë nr. ** prot., datë 02.10.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të Arjola Cana, me gjendje në datën 10.03.2023, në shumën 135.140 lekë, e krijuar nga pagesat si studente ekselente.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e Credins Bank.**
- ✓ **Diferenca në gjendjet e llogarisë është krijuar nga ndryshimi në datat e pasqyrave bankare me atë të deklarimit.**

Gjetje të tjera:

Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, subjekti ka deklaruar adresë të rregjistrimit në Gjendjen Civile në:

1. Njësia Administrative nr.3, Lagjja "8 Shkurti", Rruga "Thoma Kopaçe", pallati nr.x, hyrja nr.x, shkalla x, ap. x, Fier.
 2. Vendqëndrim tjetër: banesë e përkohshme me qira: Njësia Bashkiake nr.2, Rruga "Shyqyri Ishmi", pallati nr. x, shkalla x, ap.x, Tiranë.
- Në procesverbalin e datës 13 nëntor 2023, në lidhje me vendbanimin e tij në periudhën para se të fillonte jetesën në apartamentin e blerë nga EKB në Fier, subjekti deklaroi se ka jetuar së bashku me bashkëshorten, në shtëpinë e prindërve të saj, që është gjithashtu në Fier. Kur ka hyrë në apartamentin e tij ka bërë një mobilim të thjeshtë, i cili ka patur një vlerë të përballeshme prej tij, pasi sikurse shihet edhe nga dokumentet, apartamenti ka një sipërfaqe të vogël. Në vitin 2016, ka ardhur të banojë me qira në Tiranë, së bashku me familjen e tij, në të njëjtin apartament ku jeton edhe sot. Në Kukës, ku punon aktualisht, nuk ka apartament me qira. Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me adresën e vendbanimit.

- Banka e Shqipërisë, Intesa Sanpaolo Bank, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, ProCredit Bank, Fibank, Banka Amerikane e Investimeve, Union Bank, OTP Bank, Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing, Albania Leasing, Landeslease, Credins Invest, AKInvest, EasyPay shpk, Fondi Besa, NOA, IUTECREDIT Albania, Kredo Finance shpk, konfirmojnë se subjekti nuk është klient i tyre, ç`ka përputhet me deklarin e tij.
- ASHK, zyrat/drejtoritë vendore - Librazhd, Mallakastër, Devoll, Korçë, Fier, Berat, Lezhë, Lushnjë, Krujë, Gramsh, Kuçovë, Pukë, Malësi e Madhe, Kukës, Kavajë Bulqizë, Skrapar, Kolonjë, Elbasan, Peqin, Tropojë, Tepelenë, Përmet, ASHK Zonat e Stimuluara, Kamëz Vorë, Tiranë Veri, Tiranë Rurale 1, Mirditë, Mat, Tiranë Jug, Gjirokastër, Pogradec, Shkodër, Vlorë, Kurbin, konfirmojnë se në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të nuk ka pasuri të regjistruara.
- Unioni Financiar Tiranë, me shkresë nr. ** prot., datë 14.09.2023, konfirmon se Sokol Cana dhe personat e lidhur me të, për periudhën deri në 10.03.2023, nuk kanë kryer veprime me Unionin Financiar.
- QKB, me shkresën nr. ** prot., datë 01.09.2023, konfirmon se Sokol Cana dhe personat e lidhur me të nuk figurojnë të jenë pajisur me NUIS si persona fizikë ose të zotërojnë aksione në shoqëri tregtare të regjistruara në regjistrin tregtar.
- DPI, me shkresën nr. ** prot., datë 08.09.2023, konfirmon se Sokol Cana dhe personat e lidhur me të, nuk figurojnë të jenë të regjistruar në organet tatimore për ushtrim të ndonjë aktiviteti privat.
- Drejtoria e Përgjithshme Detare, me shkresën nr. ** prot., datë 20.09.2023, konfirmon se nuk rezultojnë të regjistruara mjete lundruese në pronësi të Sokol Cana dhe të personave të lidhur me të.

✓ ***Në konkluzion për vlerësimin e pasurisë, në përputhje me pikën 6 të nenit 34 të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, trupa vlerësuese, arrin në përfundimin se:***

- a) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe se punonjësi nuk gjendet në situatë konflikti interesi;***
- b) nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;***
- c) nuk është kryer fshehje e pasurisë;***
- ç) nuk është kryer deklarim i rremë;***
- d) punonjësi nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.***

Analiza financiare e subjektit dhe personave të lidhur me të

Burimi/Viti	1993-2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	TOTALI												
Te ardhura neto nga paga sipërblime nga marrëdhëniet e punësimit	2,153,063	719,749	672,595	642,763	765,389	836,997	661,167	807,977	833,612	834,252	1,084,472	1,274,285	1,301,259	1,228,539	1,181,464	1,220,904	1,308,862	1,525,817	1,868,068	1,282,580	391,337	22,345,181												
Te ardhura neto nga trajtimet me pagese për bashkohorët	109,775	111,150	115,093	50,089	117,648	180,844	169,873	81,491	175,694	184,360	220,732	234,432	78,144				2,002	87,997	90,000	84,838	34,839	1,916,215												
Te ardhura nga fakulteti-Vajza																						99,000	299,676											
Te ardhura neto nga interesat bankarë									18,813	27,948	25,797												72,558											
Te ardhura te krijuara nga shitja e pasurive te hulumtues dhe te pajushime	291,360																						291,360											
Te ardhura te krijuara nga investimi ne treg																							402,064											
Te hyra nga durrimet																							-											
Totali i te Ardhurave dhe te hyrat	2,548,198	830,899	787,688	692,852	883,037	1,017,841	825,040	889,468	1,028,059	1,046,560	1,281,001	1,508,717	1,379,403	1,228,539	1,181,464	1,220,904	1,310,864	1,413,814	1,958,068	1,466,418	828,270	25,327,084												
Dejtime: Te hyra nga luatekredi												110,800											110,800											
Shpenzime jetike sipas INSTAT	1,823,508	280,836	332,136	332,136	707,184	408,840	639,756	639,756	639,756	418,644	418,644	860,849	822,553	916,745	938,376	953,388	995,868	1,018,968	981,838	1,037,760	172,960	15,301,571												
Shpenzime per Qera														80,000	240,000	240,000	240,000	240,000	240,000	240,000	240,000	60,000	1,580,000											
Shpenzime për Mjekim																							-											
Shpenzime për Arsimin																							-											
Shpenzime Udhëtimi jashte vendit																							-											
Shpenzime Kredite Bankare, Hun Leasing													22,702	74,772	13,326								110,800											
Shpenzime dhe te dala te tjera																							-											
Totali i shpenzimeve dhe te dalme	1,823,508	280,836	332,136	332,136	707,184	408,840	639,756	639,756	639,756	418,644	418,644	863,551	897,325	1,010,071	1,138,376	1,199,388	1,235,868	1,258,968	1,221,838	1,277,760	232,960	16,992,371												
Investime pasuri-shopi banimi	103,482																						103,482											
Investime pasuri-autoretore			240,000					240,000															100,000											
Lik. ALL S.Cana-RFZ Bank- llog paga			44,985	-	38	55,795	-	40,662	11,199	-	178,913	178,880	-	41,548	-	302,66	19,558	-	8,468	155,314	-	14,722	-	23,183	-127,946	74,801	313,991	-27,291	220,343	582,835				
Lik. ALL A. Cana-RFZ Bank																								50,000	-	6,532	-	28,002	-3,579	1,328	10,559			
Lik. ALL A. Cana-Credins Bank																								2,002	68,820	66,454	-6,593	4,457			135,140			
Lik. ALL M. Cana-RFZ Bank- llog paga			51,786	-	103,114	159,494	-	119,444	137,523	24	-	365,113		132,732	234,399	-	367,175	445,289	38	38	38	38	38	38	38	38	38	38	38	445,517				
Lik. ALL M. Cana-RFZ Bank-Depozite								180,200			393,300	42,900	61,640																		-			
Lik. ALL M. Cana-BKT Bank- llog paga											175,542	184,360	-	359,848	-	61															-			
Lik. ALL M. Cana-Tirana Bank- llog paga																															98,627	-	375	98,252
Kuota ne Raiffeisen Im est M.Cana																																728,200	315,462	1,044,662
Lik. ALL S. Cana-BKT Bank- llog paga										6,576	4,272	4,272																					6,576	
Bleje Bono Thesari-S.Cana							1,000,000							-	400,000																		-	
Kuota ne Raiffeisen Im est S.Cana																																	600,000	600,000
Gjendje Cesh (ndryshimet shtrim/policesim)																																	600,000	
Totali Pasuri	103,482	-	336,771	-	103,152	215,289	1,078,782	328,922	-	418,889	390,185	189,991	-	148,848	-	146,104	-	375,643	600,608	-	14,684	-	23,146	-	75,906	297,127	352,481	61,202	1,025,191	3,613,665				
Mundesia per Kurzime:																																		
Te Ardhura+Dejtime- Shpenzime-Pasuri	621,208	1,171,271	1,290,652	1,753,870	1,714,434	1,248,633	1,099,995	1,768,596	1,766,714	2,204,639	3,215,844	4,097,914	4,955,695	4,573,500	4,631,302	4,681,969	4,832,865	4,750,594	5,134,283	5,241,739	4,831,858													

B. KONTROLLI I FIGURËS:

1. Objekti i kontrollit të figurës, sipas nenit 35 të Ligjit nr.12/2018, të ndryshuar është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.
2. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, e kryer nga Trupa Vlerësuese është mbështetur në katër elementë:
 - (i) të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e kontrollit të figurës, sipas përcaktimeve të Nenit 36, pika 1, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
 - (ii) raporti i hollësishëm dhe i arsyetuar i strukturës përgjegjëse pranë AMP-së, sipas përcaktimeve të Nenit 42, pika 1, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
 - (iii) të dhënat e mbledhura nga Trupa e Vlerësimit, në institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve të Nenit 36, pika 3, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
 - (iv) verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të Nenit 36, pika 3, gërma “ë”, e Ligjit 12/2018, i ndryshuar.
3. Subjekti Sokol Cana ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në zbatim të Nenit 36, pika 1, e Ligjit nr.12/2018, të ndryshuar.
4. Në Raportin mbi Kontrollin e Figurës për subjektin e vlerësimit nr. ** prot., datë 03.01.2024, përgatitur nga AMP, trupa është informuar se subjekti i vlerësimit Sokol Cana është i përshatshëm për vazhdimin e detyrës.
5. Në Deklaratën për Kontrollin e Figurës¹, Subjekti i vlerësimit, Sokol Cana, nuk ka raportuar ndonjë të dhënë për të cilën duhej të fillonte verifikimi i thelluar sipas kritereve dhe kushteve të ligjit nr.138/2015, dhe në zbatim të detyrimit të ligjit të posaçëm nr. 12/2018, i ndryshuar.

1

- Nuk ka pasur emër apo mbiemër tjetër më parë.
- Nuk është njohur nga të tjerët me ndonjë nofkë, emër apo mbiemër tjetër nga ai që ka të regjistruar në gjendjen civile.
- Nuk ka patur shtetësi tjetër.
- Nuk është dënuar ndonjëherë më vendim gjyqësor të formës të prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj.
- Nuk ka qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk është ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë penale.
- Nuk ka patur urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk është marrë ndonjëherë masa e dëbimit nga një shtet i huaj.
- Nuk është në dijeni të përfshirjes së ndonjë nga anëtarët e familjes në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka patur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi të qëllimshëm, me një ose shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës.
- Nuk ka patur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar gjatë ushtrimit të detyrës.
- Nuk është në dijeni që anëtarët e familjes kanë patur kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk është në dijeni që ndonjë nga anëtarët e familjes të ketë pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Gjatë 10 viteve të fundit, nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s.
- Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keqprezantuar, falsifikuar, një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të vecantë apo të ketë gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryejë aktivitet të pa autorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka kërkuar ndonjëherë azil politik.
- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Nuk ka varësi nga alkoli dhe lojrat e fatit.
- Nuk ka vuajtur nga crregullime mendore kronike.
- Nuk ka qenë anëtar, bashkëpunor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1991 sipas ligjit “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish-shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

6. Për të kontrolluar figurën dhe saktësinë e deklaramit për subjektin e vlerësimit, janë kryer veprimet duke kërkuar të dhëna me anë të korrespondencës pranë këtyre institucioneve:

✚ **AKSIK**

✚ **SHISH**

✚ **AMP**

✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve**

✚ **Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria Gjyqësore**

✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile**

✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit**

✚ **Avokati i Popullit**

✚ **AIMS**

✚ **Prokuroria e Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK)**

✚ **Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit**

✚ **AIF**

7. Procedura për kontrollin e figurës është kryer sipas përcaktimeve të Nenit 36-37, të ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” të ndryshuar, bazuar në kontrollin e deklaramit dhe marrjes së informacionit apo materialeve të tjera nga institucionet publike dhe ato ligjzbatuese, duke i vlerësuar ato bazuar në dispozitat e neneve 38 – 41, të Ligjit nr.12/2018, të ndryshuar.

8. Në bazë të informacionit të dërguar nga institucionet përgjegjëse, ka rezultuar se:

- ✓ Subjekti i vlerësimit është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret”, me datë lëshimi 12.11.2019, të vlefshme deri në datë 11.11.2024.
Nga AKSIK nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm CSP. AKSIK nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.
- ✓ Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën e saj bën me dije se për subjektin e vlerësimit Sokol Pelivan Cana, më datë 24.02.2002, është ndryshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Memaliaj rubrika e mbiemrit nga “Canaj” në “Cana”, sipas të dhënave të pasqyruara në regjistrin themeltar të regjistrimit të popullsisë të vitit 1974, “8 Shkurti”, me referencë 78/31.
- ✓ Nuk ka patur ankesa të trajtuara apo hetime administrative të nisura kryesisht nga Avokati i Popullit, konfirmuar me shkresë.
- ✓ Nuk ka denoncime nga publiku në faqen zyrtare të AMP dhe nuk disponohen ankesa për subjektin e vlerësimit.

- ✓ Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, konfirmon se shtetasi Sokol Pelivan Cana dhe Mimoza Th. Cana nuk rezultojnë të dënuar.
- ✓ Institucioni ligjzbatues dërgon informacion se subjekti i vlerësimit si dhe personat e tij të lidhur, nuk rezultojnë të përfshirë në veprimtari që çenojnë sigurinë kombëtare, apo aktivitete të kundraligjshme.
- ✓ Institucioni ligjzbatues dërgon informacion se për subjektin e vlerësimit dhe personat e tij të lidhur nuk administrohen informacione ose materiale mbi përfshirjen në aktivitete të kundërligjshme, nuk ka të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga ndonjë shtet i huaj, nuk ka të dhëna nëse gjatë 10 viteve të fundit i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s, apo nëse është kërkuar azil politik në ndonjë shtet të huaj.
- ✓ Institucioni ligjzbatues dërgon informacion se për subjektin e vlerësimit nuk disponon të dhëna.
- ✓ Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria e Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), informon se për subjektin e vlerësimit nuk ka nxjerrë urdhër ndalimi, nuk ka kërkuar masa të sigurimit personal (masa shtrënguese/ masa ndaluese, sipas përcaktimeve të nenit 227, të Kodit të Procedurës Penale) dhe vlerësimi i tyre nga Gjykata, nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo person nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35, të Kodit të Procedurës Penale, nuk ka pasur regjistrim të njoftimit të veprave penale sipas përcaktimit të nenit 278, të Kodit të Procedurës Penale dhe nuk ka pasur raste të urdhërave ndërkombëtarë të ndalimit.
- ✓ Institucioni ligjzbatues për subjektin e vlerësimit informon se nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitete të kundërligjshme, nuk ka procedime penale të referuara dhe nuk administrohen të dhëna ose informacione.
- ✓ AIDSSH-ja për subjektin e vlerësimit bën me dije se nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 korrik 1991.

9. Testimi për përdorim lëndësh narkotike

9.1 Në zbatim të Nenit 38, pika 2, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, me qëllim vlerësimin e besueshmërisë së punonjësit dhe deklarimeve personale, subjekti i vlerësimit ka kryer testin për përdorim lëndësh narkotike.

9.2 Në përfundim të testit, sipas ekzaminimit toksikologjiko-ligjor nr. xxx, datë 25.03.2024, të ardhur nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, me shkresë nr. ** prot., datë 26.03.2024, jemi bërë me dije se:

“Në mostrën e marrë subjektit nuk u zbulua prania e produkteve të lëndëve narkotike të grupit të MOP (opiate/heroinë), COC (cocaine), MTD (metadon), THC (canabinoide/cannabis sativa), BARB (barbiturate), TCA (trciklike antidepresante), AMP (amphetamine), MDMA (ekstazi), MET (metamfetamina), BZO (benzodiazepine).

✓ *Në konkluzion për vlerësimin e figurës, në përputhje me pikën 3 të nenit 42 të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, trupa vlerësuese, arrin në përfundimin se:*

- a) punonjësi nuk ka kryer deklarin të rremë;*
- b) nuk ka informacione, të dhëna të vërtetuara nga agjencitë ligjzbatuese që punonjësi është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar;*
- c) nuk ka informacion në deklarinin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj, që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.*

C- VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

- 1.** Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit, në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit; respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në zbatim të ligjit të vlerësimit nr.12/2018, i ndryshuar, si dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të Policisë së Shtetit, sipas përcaktimit në nenin 43, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
- 2.** Analiza ligjore e vlerësimit të aftësive profesionale e kryer nga Trupa Vlerësuese është mbështetur në:
 - a) të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
 - b) të dhënat e mbledhura në institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 6, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
 - c) raporti i hollësishëm dhe i arsyetuar, i strukturës përgjegjëse pranë DPPSH-së sipas përcaktimeve të Nenit 46, pika 2, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
- 3.** Trupa përdor si burime për vlerësimin e aftësive profesionale, elementet vlerësuese të përcaktuara në nenin 45, pika 2, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.
- 4.** Gjithashtu, Trupa e Vlerësimit mban në konsideratë dhe merr në shqyrtim edhe nëse ka denoncime nga publiku për sjellje jo profesionale të punonjësit, apo informacione të tjera të lidhura me ushtrimin e detyrës së tij në mënyrë joetike.
- 5. Afati kohor brenda të cilit shtrihet procesi i vlerësimit të aftësive profesionale:**

5.1 Subjekti i vlerësimit, ka dorëzuar në njësinë e burimeve njerëzore të institucionit ku punon formularin e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

5.2 Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën bazuar në përcaktimet e Nenit 44, pika 2 dhe 3, e tij ².

5.3 Subjekti i vlerësimit kalimtar në momentin e dorëzimit të dokumentacionit ka ushtruar detyrën e Zëvendës drejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës.

6. Niveli i arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin, të subjektit të vlerësimit:

6.1 Subjekti i vlerësimit sipas të dhënave të administruara ka përfunduar arsimin e lartë dhe është diplomuar:

➤ **Shkolla e Lartë e Bashkuar e Oficerëve, Diploma nr. 5953, datë 28.07.1986**

6.2 Në kuptim të legjislacionit për Policinë e Shtetit në vite, Ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe VKM Nr. 750, datë 16.09.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”, si dhe bazuar në kriteret dhe kërkesat e vecanta të pozicioneve të punës për funksionet përkatëse që ka mbajtur subjekti për periudhën e përcaktuar në pikat 2 e 3, të nenit 44, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, rezulton se: Subjekti i vlerësimit ka qenë në përmbushje dhe përputhje të kriterit të nivelit arsimor për funksionet që ka ushtruar, si dhe me gradat policore që ka mbajtur si punonjës i Policisë së Shtetit.

7. Të dhënat për punësimin dhe ecuria në karrierë:

7.1 Neni 45, pika 2, gërma “dh”, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar përcakton se: në lidhje me objektin e vlerësimit të aftësive profesionale shërbejnë ecuria në karrierë dhe procesi i fitimit të gradës, sipas legjislacionit në fuqi.

7.2 Struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore e Policisë së Shtetit na ka vënë në dispozicion dosjen e personelit të subjektit të vlerësimit, në të cilën përfshihen akte të ndryshme që i përkasin arsimimit, punësimit, ngritjes në detyrë, gradimeve, kualifikimeve, vlerësimeve, etj... të cilat janë marrë në analizë për vlerësimin profesional të subjektit.

².Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 vjet. 3. Në rast se punonjësi, në momentin e plotësimit të formularit të vetëvlerësimit profesional, ka më pak se 5 vjet në gradën dhe/ose pozicionin që mban, periudhë vlerësimi konsiderohet e gjithë koha e ushtrimit të detyrës në institucionin përkatës.

- 7.3 Në formularin e aftësive profesionale plotësuar nga subjekti i vlerësimit si dhe nga dosja personale e subjektit rezulton se 5 (pesë) vitet e fundit subjekti i vlerësimit ka punuar në funksionet si më poshtë:
- **Specialist Analize dhe Vlerësimit të Kërcënimit, pranë DPPSH për periudhën 01.06.2017 deri në 18.10.2021 - sipas Urdhërit nr. 287, datë 19.05.2017 të Drejtorit të Policisë së Shtetit.**
 - **Drejtor i Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Gjirokastrë për periudhën 19.10.2021 deri në 16.12.2022 - sipas Urdhërit nr. 1555, datë 18.10.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.**
 - **Zëvendës drejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës për periudhën 17.12.2022 deri në momentin e dorëzimit të Formularit të Vlerësimit të Aftësive Profesionale dhe aktualisht - sipas Urdhërit nr. 1742/2, datë 16.12.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.**
- 7.4 Bazuar në nenin 179, pika 10, e Rregullores së Policisë së Shtetit përcaktohet se *transferimi i punonjësit të Policisë bëhet bazuar në kriteret e përcaktuara, të cilat duhet të jenë në përputhje me gradën, kualifikimet, vlerësimet individuale të punës, kohën e qëndrimit në funksion, si dhe me përshkrimin e pozicionit të punës për atë funksion.*
- 7.5 Sipas Vendimit nr.892, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese dhe kategorizimi për Gradat në Policinë e Shtetit”, sipas Tabelës së Funksioneve Korresponduese dhe Kategorizimit për çdo Gradë”, funksioni Drejtor i Drejtorive Vendore të Policisë Kufitare dhe Migracionit duhet të jetë me gradën “Drejtues”.
- 7.6 Subjekti i vlerësimit Sokol Cana, në momentin e emërimit dhe deri në 01.08.2022, të mbajtjes së funksionit si Drejtor i Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Gjirokastrë, ka qenë me gradën Kryekomisar.
- 7.7 Sipas nenit 180, pika 1, e Rregullores së Policisë së Shtetit, *punonjësi i Policisë mund të transferohet dhe të emërohet në detyrë në çdo strukturë të Policisë së Shtetit, në përputhje me gradën që ka.*
- 7.8 Në rastin e transferimit dhe emërimit në detyrë të subjektit, në funksionin e lartpërmendur nuk është mbajtur parasysh përputhja e funksionit me gradën, sipas legjislacionit në fuqi të sipërcituar, pasi subjekti duhet të kishte përfituar dhe të gëzonte gradën “Drejtues”.

7.9 Aktualisht që prej datës 17.12.2022, subjekti mban detyrën e Zëvendësdrejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës, ku emërimi dhe ushtrimi i këtij funksioni është në përputhje të plotë me Vendimin nr.531, datë 29.07.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e Numrit të Përgjithshëm të Personelit të Policisë së Shtetit dhe Përcaktimin e Funksioneve Korresponduese dhe Kategorizimin për Gradat në Policinë e Shtetit”.

7.10 Nga aktet e dosjes së personelit, rezulton se subjekti i vlerësimit deri në momentin e deklarimit (5 vitet e fundit) ka përfituar gradat policore si më poshtë:

➤ **Drejtues:** **Urdhër nr.1742, datë 28.07.2022**

7.11 Subjektit me Urdhërin nr.1128, datë 07.05.2010, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, i është dhënë grada “Kryekomisar”.

7.12 Sipas Urdhërit nr.1742, datë 28.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për dhënien e gradës policore një punonjësi policie”, subjekti ka marrë gradën “Drejtues”.

7.13 Trupa Vlerësuese konstatoi se përfitimi i gradës Drejtues është kryer sipas dokumentacionit si më poshtë:

- Urdhëri nr.1026, datë 10.11.2021, “Për hapjen e fazës së aplikimeve për konkurim për fitimin e gradës “Drejtues i Parë” dhe “Drejtues”.
- Vendimi nr.2814/14, datë 22.04.2022, të Komisionit të Gradimit për vlerësimet e aplikantëve që konkurojnë për fitimin e gradës “Drejtues”.
- Urdhëri nr.408/1, datë 05.05.2022, të Drejtorit të Policisë së Shtetit “Për miratimin e listës emërore të së drejtës për gradë të aplikantëve fitues”.
- Shkresa nr.1558 prot., datë 22.07.2022, të Akademisë së Sigurisë “Mbi dërgimin e dosjes së kursit”, së bashku me certifikatën e përfundimit me sukses të trajnimit për fitimin e gradës “Drejtues”.
- Urdhëri nr.1742, datë 28.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për dhënien e gradës policore një punonjësi policie”, subjekti ka marrë gradën “Drejtues”.

7.14 Në përfundim të verifikimit, rezulton se grada është përfituar në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

8. Vlerësimet e punës:

8.1 Neni 45, pika 2, gërma “ç”, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, përcakton se: në lidhje me objektin e vlerësimit të aftësive profesionale shërbejnë edhe vlerësimet e punës.

- 8.2 Nga aktet e depozituara pranë Trupës Vlerësuese dhe sipas shkresës kthim përgjigje nr. ** prot., datë 18.04.2024, të DPPSH-së, rezulton se për periudhat 2020, 2021, nuk ka vlerësime pune të administruara në dosje për subjektin.
- 8.3 Sipas deklaramit të subjektit në formularin e aftësive profesionale për vitin 2020, është vlerësuar “shumë mirë” me 27 pikë dhe për vitin 2021, është vlerësuar “shumë mirë” me 28 pikë.
- 8.4 Gjithashtu, me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.37, datë 12.01.2021, është vlerësuar me Certifikatë për “Shërbime të Dalluara”.
- 8.5 Për vitet 2018 dhe 2019, rezulton me vlerësimin “shumë mirë” (28 pikë në total) për të gjithë treguesit si: integriteti, profesionalizmi, komunikimi efektiv, qëndrimi konstruktiv, paanshmëria, puna në grup dhe organizimi i punës.
- 8.6 Për vitin 2022, subjekti është vlerësuar “shumë mirë” (94 pikë në total), duke arritur për komponentin e “realizimit të objektivave të punës” të vlerësohet me 58 pikë, nga 60 pikë në total dhe për komponentin e “sjelljes profesionale” është vlerësuar me 36 pikë, nga 40 pikë në total.
- 8.7 Institucioni i Avokatit të Popullit, me shkresë ka konfirmuar se nuk ka pasur ankesa të trajtuara apo hetime administrative të nisura kryesisht për subjektin.
- 8.8 Pranë AMP-së, nuk kanë ardhur denoncime/ankesa nga publiku për subjektin për sjellje joprofesionale dhe joetike, gjatë ushtrimit të detyrës, sipas parashikimit ligjor të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

9. Përbushja e detyrave të kryera

- 9.1 Neni 43, i Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, përcakton se objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është dhe përbushja e detyrave nga punonjësi, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin përkatës që rregullon veprimtarinë e punonjësit.
- 9.2 Neni 45, pika 1, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar përcakton se: aftësitë profesionale të punonjësit vlerësohen duke u bazuar dhe në përshkrimet e punës për cdo funksion.
- 9.3 Nga verifikimi rezulton se subjekti ka kryer dhe ka përbushur detyrat në përputhje me përshkrimet e punës për cdo funksion.

10. Respektimi i rregullave të etikës/masat disiplinore:

10.1 Neni 43, i Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, përcakton se objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është dhe respektimi i rregullave të etikës.

10.2 Nga verifikimi i dosjes së personelit dhe sistemit RMIS, rezultoi se ndaj subjektit të vlerësimit nuk ka masa disiplinore në fuqi apo të parashkruara, për shkelje të rregullave të etikës, sipas përcaktimeve të nenit 43, të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

11. Kualifikimet dhe trajnimet:

11.1 Nga verifikimi dosjes së personelit të subjektit si dhe verifikimit të pikës 3, të pjesës 3, të formularit të aftësive profesionale të dorëzuar nga subjekti, rezulton se është pajisur me çertifikata për kryerje kursesh, shkollime dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit, për 5 vitet e fundit, të listuara më poshtë:

- Seminar për rritjen e aftësive teknike dhe hetimore të njësisë të hetimit të antiterrorit, organizuar nga projekti PAMECA V, 03-05 Prill 2018;
- Trajnim “Shoqëria civile kundër ekstremizmit të dhunshëm”, organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 20 Prill 2018;
- Trajnim mbi programin NOTEBOOK I2, organizuar nga projekti PAMECA V, 16-27 Korrik 2018;
- Trajnim “Përputhja e standarteve të drejtave të njeriut dhe lufta efektive e terrorizmit”, organizuar nga OSCE-ODIHR, 19-20 Nëntor 2018;
- Trajnim “Forumi Ekzekutiv mbi konsultimin për luftëtarët e huaj terroristë”, organizuar nga asistenca kundër terrorizmit në DASH-USA, 10-14 Dhjetor 2018;
- Trajnim “Hetimet mbi përdorimin e kriptomonedhave në pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit “, organizuar nga UNODC, 5-6 Mars 2019;
- Trajnim “Hetimet mbi përdorimin e teknologjisë nga terroristët”, organizuar nga asistenca kundër terrorizmit në DASH-USA, 25-26 Prill 2019;
- Trajnim “Mbi shfrytëzimin dhe monitorimin e burimeve të hapura”, organizuar nga projekti PAMECA V, 13-17 Maj 2019;
- Trajnim “Mbi funksionimin e avancuar për ngarkimin dhe trajtimin e skedarëve excel në I2 Analyst Notebook”, organizuar nga projekti PAMECA V, 20-24 Maj 2019;
- Trajnim “Program shtojcë të I2 Notebook mbi monitorimin automatic në media sociale”, organizuar nga projekti PAMECA V, 10-14 Qershor 2019;

- Trajnim mbi praktikat më të mira të Hagës mbi lidhjen midis krimit të organizuar ndërkombëtar dhe terrorizmit, organizuar nga CVE, UNICRI dhe NEXUS, nga data 1-2 Tetor 2020.

11.2 Të gjitha trajnimet e kryera nga subjekti gjatë karrierës së tij duke përfshirë dhe periudhën sipas përcaktimeve të Nenit 44, pika 2 dhe 3, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, kanë shërbyer për thellimin e njohurive, shtimin e vlerave dhe rritjen e performancës në ushtrimin e profesionit të profilit të tij.

11.3 Gjithashtu konstatohet se: Trajnimet dhe pajisja me certifikata trajnimi janë të lidhura dhe në përputhje me objektin e ushtrimit të funksioneve të tij, në detyra të ndryshme ku ka punuar.

12. Pjesëmarrja në konferenca shkencore, Workshop-e, botime brenda ose jashtë vendit.

Duke ju referuar pikës 5, të pjesës 3, të formularit të aftësive profesionale të dorëzuar nga subjekti, ai ka deklaruar se është angazhuar për 5 vitet e fundit, si vijon:

- Seminar me temë “Mbi aspekte të ndryshme të krimit financiar”, organizuar nga Ambasada Britanike në Tiranë, 01 mars 2018.
- Workshop për “Rritjen e aftësive teknike dhe hetuese të njësive antiterrorizëm” dhe ballafaqim me ndryshimet e bëra në Kodin e Procedurës Penale Shqiptare, organizuar nga misioni PAMECA V, 26-28 Mars 2018.
- Anëtar i grupit ndërinstytucional të punës në kuadër të Kapitullit 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria”, si dhe anëtar i delegacionit shqiptar pjesëmarrës në Konferencën e parë Ndërqeveritare mbi përafrimin e legjislacionit shqiptar kundër terrorizmit me ACQUIS të BE, në selinë e KE, Bruksel.

(Pjesëmarrjet në konferenca shkencore, nuk administrohen në dosjen e personelit pasi nuk janë pjesë e saj)

- ✓ *Në konkluzion për vlerësimin e aftësive profesionale, në përputhje me pikën 1 të nenit 47 të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, trupa vlerësuese, arrin në përfundimin se:*
 - a) është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;*
 - b) ka vlerësime pozitive pune;*
 - c) ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban.*

V. KONKLUSIONI PËRFUNDIMTAR

Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi

subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti i vlerësimit **Z. Sokol Cana**, në përputhje me nenin 60, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë,
- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës,
- Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2, të nenit 60, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit, **Z. Sokol Pelivan Cana**, me funksion Zëvendësdrejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit brenda 15 ditëve, nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve, nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, sot datë **28.06.2024**.

TRUPA E VLERËSIMIT

Henri Naqellari
Kryesues

Loreta Hanxhari
Relatore

Bora Vrenjo
Anëtare

